



## Republika e Kosovës - Republic of Kosova

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës  
The Union of Education, Science and Culture

Rr. Agim Ramadani p.n. - Qendra e Studentëve 10000 Prishtinë, Tel/Fax: +381(0)38/226-940  
[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org) E: [sbashk2004@yahoo.com](mailto:sbashk2004@yahoo.com), [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Publikuar më: 14.04.2022

### Kongresi i 8-të i SBASHK-ut miraton:

#### Rezoluta për fillimin e veprimeve sindikale

1. Pasi që kërkesat e SBASHK-ut drejtuar Kryeministrit që nga data 06.04.2021 dhe e përsëritur edhe me datën 16.11.2021 për takime për të biseduar lidhur me kërkesat e anëtarësisë të bëra publike qysh në tetor 2021 janë injoruar nga Qeveria;
2. Duke vërejtur se gatishmëria e anëtarësisë me rastin e deklarimeve për veprime sindikale ka qenë në nivel shumë të lartë për t'iu përgjigjur thirrjes së Kryetarit të SBASHK-ut për veprimet sindikale, duke duke mos përjashtuar edhe grevën e përgjithshme;
3. Duke marrë për bazë ftesën që i është bërë Kryeministrit për t'ju drejtuar Kongresit të 8 të SBASHK-ut dhe mos gatishmëria e tij për këtë;
4. Duke pasur parasysh se rritje të pagave s'ka pasur nga viti 2011 e nga ajo kohë buxheti i Kosovës është rritur rreth 70% kurse pagat vetëm 4% ;
5. Duke vërejtur mosgatishmërinë e Qeverisë që ngritjen ekonomike ta pasqyrojë me ngritjen e pagës bazë për aq vite sa nuk pasur rritje të pagave që është rreth 30% ;
6. Duke vërejtur injorimin e kërkesës drejtuar Qeverisë për rritje të pagës në shumën prej 100 € deri në fillimin e zbatimit të ligjit të pagave në Kosovë;
7. Duke vërejtur injorimin e kërkesës drejtuar Qeverisë për përfshirjet e përfaqësuesit të SBASHK-ut në komisionin për hartimin e Ligjit të pagave për shërbyesit publik dhe gjithashtu injorimin e propozimeve të SBASHK-ut lidhur me këtë ligj;
8. Duke vërejtur injorimin e kërkesës drejtuar Qeverisë për të filluar grumbullimin e fondit apo për ta amendamentuar Ligjin e sigurimeve shëndetësore me qëllim të fillimit të implementimit pasi që Kosova është i vetmi vend në Evropë që nuk ka sigurime shëndetësore
9. Duke vërejtur injorimin e kërkesës drejtuar Qeverisë për amendamentimin e Ligjit 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, të nenit 8 që kërkohen:

*1.2. duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999,*

*1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999. ( të kenë 15 vite )*

Edhe pse dihet se këto kontribute janë plaçkitur nga Serbia .

**10.** Duke pasur parasysh situatën jo të mirë politike në vende e dhe në rajon;

**11.** Duke identifikuar institucionet dhe udhëheqësit e tyre për pengesat që paraqiten në zbatimin e Kontratës Kolektive dhe akteve tjera ligjore.

### **Kongresi i 8-të i SBASHK-ut për këto arsye:**

1. Obligon Kryetarin e SBASHK-ut në bashkëpunim me Kryesinë e SBASHK-ut , që me datën **08 prill 2022** të organizojë protestë në Prishtinë në shenjë të reagimit ndaj mosplotësimit të kërkesave, nëse deri me këtë datë nuk ka veprime konkrete.
2. Obligon Kryetarin e SBASHK-ut që:
  - a. të bëjë angazhime maksimale me qëllim të realizimit të kërkesave brenda intervalit kohor **08 prill deri 20 prill 2022**;
  - b. të bisedojë me BSPK dhe Federatat tjera sindikale për tu bërë edhe ato pjesë e veprimeve të përbashkëta sindikale
  - c. të informojë Edukimin Ndërkombëtar ( EI ) dhe Komitetin Evropian të Sindikatave të Arsimit ( ETUCE ) për zhvillimet me aktivitet e SBASHK-ut dhe të kërkojë nga ta që t'i informojnë organet Evropian dhe Botërore që kanë të bëjnë me Dialogun Social;
3. Obligon Kryetarin e SBASHK-ut të përdor të gjitha veprimet sindikale të parapara me ligjet e Republikës së Kosovës deri me datën **20 prill 2022** dhe pas kësaj date nëse s'ka marrëveshje të nënshkruar për plotësimin e kërkesave të shpall grevë të përgjithshme deri në realizimin e kërkesave duke analizuar mundësinë edhe për protesta publike me datën 1 maj 2022 në bashkëpunim me Kryetarin e BSPK dhe Kryetarët e Federatave e shoqatave tjera sindikale .
4. Obligon Kryetari i SBASHK-ut që në bashkëpunim me Kryetarin e BSPK , nëse vjen deri të greva e Përgjithshme, të kërkohen dorëheqjet apo shkarkimet e udhëheqësve që po pengojnë realizim e kërkesave të meritashme dhe kjo t'i bashkëngjitet kërkesave tjera.
5. Kryetari i SBASHK-ut ka autorizim të plotë për të vepruar sipas rrethanave të krijuara tani dhe në të ardhmen lidhur me veprimet sindikale.